UDHËZIM
Nr.13, datë 26.9.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.994, DATË 12.3.2003 "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AUTOSHKOLLAVE" TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, neneve 119, 120 dhe 121 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të neneve 310, 311 dhe 313 të vendimit nr.153, datë 7.4.2000 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë" të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.994, datë 12.3.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e autoshkollave", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Pika 7, neni 4, ndryshohet si më poshtë vijon:

"7. Plotësimi i kërkesës për automjetet mësimore për lejedrejtimi të kategorisë "C+E", sipas pikës 10, neni 313, shkronja "d", të vendimit nr.153, datë 7.4.2000, të ndryshuar, duhet të realizohet brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.".

Neni 2

Neni 11 ndryshohet si më poshtë vijon:

"Personat e interesuar, për të hyrë në provën e kontrollit të njohurive teorike dhe në provën e aftësive të drejtimit e të sjelljes, për pajisje me lejedrejtimi të mjetit, sipas kategorive të parashikuara në Kodin Rrugor, regjistrohen nëpërmjet autoshkollës pranë drejtorive rajonale, pasi të paraqesin respektivisht, dokumentet e përcaktuara në pikën 2, neni 311, të rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor, si dhe formularët sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja.

Sektori përkatës i DRSHTRR-së plotëson regjistrin model DL 2/T dhe pajis me autorizim për kategorinë e kërkuar, sipas modelit DL/T, me afat kohor një vit, personat e interesuar për të hyrë në provën e njohurive teorike për lejedrejtimi mjeti.

Sektori përkatës i DRSHTRR-së plotëson regjistrin model DL 2/P dhe pajis me autorizim për ushtrimin e drejtimit të mjetit, për kategorinë e kërkuar, sipas modelit DL / P, me afat kohor një vit, personat e interesuar që kanë fituar provën e kontrollit të njohurive teorike për lejedrejtimi mjeti.

Modeli i regjistrit DL 2/T dhe DL 2/P, i autorizimit DL/T dhe DL/P, hartohen nga DPSHTRR-ja dhe janë pjesë e këtij udhëzimi.".

Neni 3

Neni 12 ndryshohet si më poshtë vijon:

"Të gjithë personat e interesuar, që nuk janë shtetas shqiptarë, mund të pajisen me lejedrejtimi të mjetit, pasi të paraqesin respektivisht, dokumentet e përcaktuara në pikën 2, neni 311, të rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor, si dhe formularët sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja. Vërtetimi i vendbanimit do të zëvendësohet me fotokopje të lejes së qëndrimit, të legalizuar.

Rregullat e përgatitjes dhe të provave, për të marrë lejedrejtimi mjeti, për këta persona të interesuar që nuk janë shtetas shqiptarë, janë të njëjta si për shtetasit shqiptarë.

Në provën e kontrollit të njohurive teorike dhe në provën e verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes, për pajisje me lejedrejtimi mjeti, personi i interesuar që nuk është shtetas shqiptar, mund të marrë dhe përkthyes.".

Neni 4

Neni 13 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Orët dhe koha e nevojshme, për përgatitjen e njohurive teorike për lejedrejtimi mjeti, në autoshkolla, janë si më poshtë:

1. Për lejedrejtimi të kategorisë A	36 orë, në jo më pak se 14 ditë;
2. Për lejedrejtimi të kategorisë B	54 orë, në jo më pak se 20 ditë;
3. Për lejedrejtimi të kategorisë C	30 orë, në jo më pak se 12 ditë;
4. Për lejedrejtimi të kategorisë D	30 orë, në jo më pak se 12 ditë;
5. Për lejedrejtimi të kategorisë BE	12 orë, në jo më pak se 5 ditë;
6. Për lejedrejtimi të kategorisë CE	16 orë, në jo më pak se 6 ditë;
7. Për lejedrejtimi të kategorisë DE	16 orë, në jo më pak se 6 ditë.

Kur personi i interesuar disponon lejedrejtimi të kategorisë A dhe aplikon për lejedrejtimi të kategorisë B, do t’i nënshtrohet përgatitjes së njohurive teorike prej 18 orësh, në jo më pak se 7 ditë (diferencën e orëve), të përcaktuara në tabelën “Programi mësimor dhe orari”.

Kur personi i interesuar disponon lejedrejtimi të kategorisë B dhe aplikon për lejedrejtimi të kategorisë A, nuk do t’i nënshtrohet përgatitjes dhe marrjes në prova të njohurive teorike për lejedrejtimi të kategorisë B.

Orët e programuara për njohuritë teorike për lejedrejtimi, do të jenë sipas programit, lidhja A.

Orët dhe koha e nevojshme, për përgatitjen e aftësive drejtuese dhe të sjelljes për lejedrejtimi mjeti, në autoshkolla, janë si më poshtë:

1. Për lejedrejtimi të kategorisë A	12 orë, në jo më pak se 10 ditë;
2. Për lejedrejtimi të kategorisë B	36 orë, në jo më pak se 30 ditë;
3. Për lejedrejtimi të kategorisë C	18 orë, në jo më pak se 15 ditë;
4. Për lejedrejtimi të kategorisë D	18 orë, në jo më pak se 15 ditë;
5. Për lejedrejtimi të kategorisë BE	8 orë, në jo më pak se 6 ditë;
6. Për lejedrejtimi të kategorisë CE	12 orë, në jo më pak se 10 ditë;
7. Për lejedrejtimi të kategorisë DE	12 orë, në jo më pak se 10 ditë.

Orët e programuara për përgatitjen e aftësive drejtuese dhe të sjelljes për lejedrejtimi mjeti, do të jenë në përputhje me nenin 313, pika 13 dhe 15, të rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor dhe të programit, lidhja A.

Koha e përgatitjes teorike dhe aftësimit të drejtimit dhe të sjelljes, janë në ditë kalendarike.”.

Neni 5

Paragrafi i fundit, neni 14, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Në këto raste plotësimi i autorizimit model DL / T dhe DL / P, nga autoshkolla, do të bëhet për kryerjen e plotë të programit.”.

Neni 6

Neni 15 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Pas përfundimit të plotë të programit të njohurive teorike ose të programit të aftësive drejtuese dhe të sjelljes, për lejedrejtimi mjeti, autoshkolla paraqet në sektorin përkatës të DRSHTRR-së, dokumentet e përcaktuara për marrjen në provë të personave të interesuar.

Sektori përkatës i DRSHTRR-së, pas paraqitjes së dokumenteve për marrjen në provë të personave të interesuar, në bashkëpunim me autoshkollën, organizon marrjen në prova, sipas afateve kohore të përcaktuara në pikën 8, neni 313, të rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor.”.

Neni 7

Neni 16 ndryshohet si më poshtë vijon:

“DPSHTRR-ja përcakton anëtarët e komisioneve të marrjes në prova për lejedrejtimi mjeti. Anëtarët e komisioneve duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikat 5 dhe 6, neni 311, të rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor.

Komisionet e kontrollit të njohurive teorike për lejedrejtimi mjeti e realizojnë provën nëpërmjet testimit, për personat e interesuar. Koha e testimit nuk duhet të jetë më shumë se 45 min.

Personat e interesuar fitojnë provën e kontrollit të njohurive teorike për lejedrejtimi mjeti, kur përgjigjen në mënyrë korrekte 30 pyetjeve ose më shumë, nga 40 pyetje që përmban testi. Testet hartohen nga DPSHTRR-ja, në përputhje me nenin 311, pika 7, të rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor.

Personat e interesuar fitojnë provën e verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes për lejedrejtimi mjeti, kur kryejnë me saktësi të gjitha kërkesat e përcaktuara në autorizimin model DL/P.

Koha e provës së verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes, për lejedrejtimi mjeti, nuk duhet të jetë më pak se 25 minuta, për kategoritë A, B dhe B+E, dhe jo më pak se 45 minuta, për kategoritë C, C+E, D, D+E.

Personat e interesuar, për provën e verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes, merren në prova me mjetin që janë regjistruar për t'u përgatitur.".

Neni 8

Neni 17 ndryshohet si më poshtë vijon:

Personat e interesuar për lejedrejtimi mjeti të pajisur me autorizim, DL / T ose DL / P, nuk mund të merren në provë përkatëse nga komisioni, pa realizuar programin e plotë të njohurive teorike ose programin e plotë të aftësive drejtuese e të sjelljes.

Personat e interesuar për lejedrejtimi mjeti kanë të drejtë të paraqiten në provë deri në 5 (pesë) herë, brenda afatit të vlefshmërisë së autorizimit model DL / T ose DL / P.

Personat e interesuar për lejedrejtimi mjeti mund të rifuten në provë, mbas 15 ditëve nga dita e provës që nuk kanë fituar.

Kur personi i interesuar për lejedrejtimi mjeti, nuk fiton provën e verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes, për një periudhë dyvjeçare, duhet të rifutet në provën e kontrollit të njohurive teorike.".

Neni 10

Në nenin 19, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shprehja "model IV-7" zëvendësohet me "model DL / T ose model DL / P".

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

"2. Evidenton çdo ditë kandidatët që paraqiten për t'u marrë në provim, në regjistrin e protokollit, "model DL 3 /T ose model DL3 / P", të hartuar nga DPSHTRR-ja, dhe janë pjesë e këtij udhëzimi.".

Neni 11

Në nenin 23, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 shfuqizohet.

2. Pika 3 ndyshon si më poshtë vijon:

"3. Merren në provim nga një komision i përbërë nga tre specialistë të DPSHTRR–së, që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 6, neni 311, të rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor.".

Neni 12

Paragrafi i fundit, neni 26, bëhen si më poshtë vijon:

"Në përfundim të seminareve, të gjithë pjesëmarrësit testohen për njohuritë e fituara. Pjesëmarrësit që arrijnë rezultat pozitiv në testim, pajisen me certifikatë. Kjo certifikatë është e vlefshme dhe si dëshmi aftësie për njohuritë teorike në autoshkolla.".

Neni 13

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

Modeli DL / T

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor

AUTORIZIM

PËR PROVËN E KONTROLLIT TË NJOHURIVE TEORIKE,
PËR PAJISJEN ME LEJEDREJTIMI TË MOTOMJETEVE DHE AUTOMJETEVE
(Ligji nr.8378, datë 22.7.1998, neni 119, VKM nr.153 datë 7.4.2000, neni 311)

KËRKUESI:

EMRI_____
MBIEMRI_____ATËSIA_____

AMËSIA_____DATËLINDJA_____/_____/_____VENDLINDJA_____

VENDBANIMI_____ADRESA_____

Foto

DOKUMENT IDENTIFIKUES _____
NR._____

KATEGORIA E LEJEDREJTIMIT QË KA "_____"
Nr.prot._____/_____datë____/____/_____

KATEGORIA E LEJEDREJTIMIT PËR TË CILËN KERKON TË AFTËSOHET "_____"
(_____)

Emër, mbiemër,firmë)

AUTOSHKOLLA
"_____*NR.LICENCËS*_____*DATË*_____/_____/_____

*PERIUDHA E PËRGATITJES NGA DATA*____/____/_____
(_____)

(me shkrim)

DERI MË DATË ____/____/_____ *(_____).*
(me shkrim)

DREJTUESI TEKNIK I AUTOSHKOLLËS (_____)
Emër, mbiemër, firmë, vulë

DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR_____
Nr._____prot. Datë____/____/_____

NËPUNËSI I NGARKUAR

(_____)

Emër, mbiemër, firmë

Udhëzues: 1. Ky është dokument publik dhe i jepet kërkuesit të tij për t'u paraqitur në testim brenda juridiksionit të drejtorisë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor që e lëshon.

2. Ndryshimi, korrigjimi ose falsifikimi i tij dënohet me ligj dhe e bën të pavlefshëm autorizimin. Në rast ndryshimi ky duhet të zëvendësohet me autorizim të ri nga drejtoria rajonale që e ka lëshuar.

PËRFUNDIMI I PROGRAMIT TË NJOHURIVE TEORIKE TË DREJTIMIT TË MJETIT

Kandidati_____i regjistruar me nr. regjistri themeltar (amzë)_____

(me shifër dhe shkrim) plotësoi orët e zhvilluara nga programi i njohurive teorike gjithsej_____(me shifra dhe shkrim), dhe deklaron se është i aftë t'i nënshtrohet provës së njohurive teorike.

DREJTUESI TEKNIK I AUTOSHKOLLËS Data (_____)

(_____)

Emër, mbiemër, firmë, vulë *(me shifër dhe shkrim)*

VLERËSIMI I KOMISIONIT TË PROVËS SË NJOHURIVE TEORIKE

Numri i provave	**Nr. protokollit e data e marrjes në prova**	**Nr. testit**	**Rezultati i provës përgjigje të sakta (me shifër e shkrim)**	**Rezultati (me shkrim) fiton/nuk fiton**	**Komisioni vlerësues (emër, mbiemër, firmë)**
I					Kryetar: Anëtar:
II					Kryetar: Anëtar:
III					Kryetar: Anëtar:
IV					Kryetar: Anëtar:
V					Kryetar: Anëtar:

Kandidati (_____) fiton **"Provën e njohurive teorike"** për leje drejtimi të kategorisë "_____" me

vendimin komisionit nr/prot._____ datë _____

KOMISIONI

ANËTARI **KRYETARI**

(_____)

(_____)

Emër, mbiemër, firmë *Emër, mbiemër, firmë*

REGJISTRI I KANDIDATËVE PER DREJTUES MJETI (TEORI)

Nr.	Datë	Emër, atësi, mbiemër	Datëlindja	Vendlindja	Vendbanimi	Seksi M/F	Kategoria që zotëron	Kategoria që kërkon	Autoshkolla	Data e fillimit	Data e mbarimit	Mësuesi i teorisë
1												
2												
3												
4												
5												
6												
7												
8												
9												
10												
11												
12												
13												
14												
15												
16												
17												
18												
19												
20												
21												
22												
23												
24												
25												
26												
27												
28												
29												
30												

Modeli DL 3 / T

REGJISTËR PROTOKOLLI PËR MARRJEN NË PROVA TEORIKE NR._____ DATË __/__/_____

Nr.	Emër, mbiemër	Atësia	Amësia	Datëlindja	Vendlindja	Vendbanimi *(Adresa)*	Autoshkolla		Kateg. që Zotëron	Nr. i provimit	Rezultati i provimit (me shkrim + kategoria)
							Nr. amzës	*Emri*			
1											
2											
3											
4											
5											
6											
7											
8											
9											
10											
11											
12											
13											
14											
15											
16											
17											
18											
19											
20											
21											
22											
23											
24											
25											
26											
27											

28											
29											
30											

Modeli DL / P

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

AUTORIZIM

PËR USHTRIMIN E DREJTIMIT TË MOTOMJETEVE DHE AUTOMJETEVE E TË PROVËS PËR VERIFIKIMIN E AFTËSIVE DREJTUESE DHE TË SJELLJES, PËR PAJISJEN ME LEJEDREJTIMI

(Ligji nr.8378, datë 22.7.1998, neni 120)

KËRKUESI:

EMRI_____
MBIEMRI_____ATËSIA_____

AMËSIA_____DATËLINDJA_____/_____/_____VENDLINDJA_____
_____

VENDBANIMI_____ADRESA_____
_____

DOKUMENTI IDENTIFIKUES _____
NR._____

KATEGORIA E LEJEDREJTIMIT QË KA "_____"
Nr.prot._____/_____datë____/____/_____

KATEGORIA E LEJEDREJTIMIT PËR TË CILËN KËRKON TË AFTËSOHET "_____"

(_____)

Emër,mbiemër,firmë)

KA FITUAR PROVAT E NJOHURIVE TEORIKE PËR LEJE DREJTIMI TË KATEG. ____ nr._____prot. ____Datë__

AUTOSHKOLLA "_____"
NR.LICENCËS_____DATË_____/_____/_____

PERIUDHA E PËRGATITJES NGA DATA ____/____/_____ (_____)

(me shkrim)

DERI MË DATË ____/____/_____ (_____).
(me shkrim)

DREJTUESI TEKNIK I AUTOSHKOLLËS

(_____)

Emër, mbiemër, firmë, vulë

DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR_____

Nr._____Prot. Datë____/____/_____

NËPUNËSI I NGARKUAR

(_____)

Emër, mbiemër, firmë

Udhëzues: *1. Ky është dokument publik dhe i jepet kërkuesit të tij për t'u ushtruar në stërvitjen praktike e për t'u paraqitur në testim brenda juridiksionit të drejtorisë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor që e lëshon.*

2. Ndryshimi, korrigjimi ose falsifikimi i tij dënohet me ligj dhe e bën të pavlefshëm autorizimin. Në rast ndryshimi ky duhet të zëvendësohet me autorizim të ri nga drejtoria rajonale që e ka lëshuar.

3. Pavarësisht nga rubrikat e shënuara te "Veprimet praktike që do të testohen", marrja në prova praktike e kandidatit për kategorinë e lejes së drejtimit të kërkuar, duhet të bëhet në përputhje me programin e hartuar në rregulloren për këtë qëllim.

PËRFUNDIMI I PROGRAMIT TË USHTRIMIT TË DREJTIMIT TË MJETIT

Kandidati_____i regjistruar me nr.regjistri themeltar (amzë)_____ (me shifër dhe shkrim) plotësoi orë të zhvilluara në mësimin praktik gjithsej_____(me shifra dhe shkrim), dhe deklaron se është i aftë t'i nënshtrohet provimit praktik.

DREJTUESI TEKNIK I AUTOSHKOLLËS

Data

(_____)

(_____)

Emër, mbiemer, firmë

Vula (me shifër dhe shkrim)

VLERËSIMI I KOMISIONIT TË PROVËS SË AFTËSIVE DREJTUESE DHE TË SJELLJES

Nr	**Veprime praktike që do të testohen**	**PROVA I DT._____**	**PROVA II DT._____**	**PROVA III DT._____**	**PROVA IV DT._____**	**PROVA V DT._____**
I	**Përgatitje dhe kontroll i mjetit me qëllim sigurinë rrugore**					
1	Rregullim i sediljes, pasqyrave, të rripave të sigurimit dhe mbështetes së mundshme të kokës					
2	Kontroll i kushteve të rrotave dhe bulonave, dritareve, pastruesve të xhamave dhe të niveleve (vaj motori, lëng ftohës, lëng për të larë xhamat etj.)					
4	Kontrolli i presionit të ajrit, i depozitës së ajrit, kompresorit dhe të jastëkëve të ajrit					
5	Kontroll i freksionit dhe					

	frenave, por edhe lidhjeve elektrike për kategori të veçanta					
II	**Manovrime të veçanta objekt i provave me qëllim sigurinë në rrugë**					
1	Lidhje dhe zgjidhje e rimorkios ose gjysmërimorkios nga makina që e tërheq					
2	Marsh indietro në linjë të drejtë ose me kthim djathtas ose majtas duke iu përmbajtur korsisë së saktë					
3	Frenim i saktë duke respektuar pikën e ndalimit të parapërcaktuar; ekzekutimi i një frenimi emergjence është i kërkuar					
4	Parkim i makinës dhe dalje nga hapësira e parkingut (paralel, drejt ose jodrejt, marsh përpara ose mbrapa; në rafsh ose në pjerrësi)					
5	Kthim i makinës, duke iu drejtuar si marshit përpara ashtu edhe marshit indietro					
6	Parkim në siguresë për veprime të ngarkim/shkarkimit ose ngjitjen/zbritjen e pasagjerëve					
III	**Sjellja në trafik**					
1	Nisja nga frenimi: nga një parking, pas një qëndrimi në trafik; duke dalë nga një rrugë sekondare					
2	Drejtimi i mjetit në rrugë të drejtë; sjellja në përballje me mjetet e tjera që vijnë në drejtim të kundërt					
3	Drejtimi i mjetit në kthesë dhe në rast të një hapësire të kufizuar					
4	Zgjedhja e korsisë së duhur përpara kryqëzimit					
5	Veprimet në kryqëzime me dhe pa semafor, me drejtues trafiku, përballim dhe kalim i kryqëzimeve dhe rrugëve të ndërlidhëse					
6	Ndryshim drejtimi: kthim djathtas ose majtas;					

	ndryshim korsie					
7	Hyrje/dalje nga autostrada (ose të rrugë të mundshme të njëjta me të): hyrje përmes korsisë së shpejtësisë; dalje përmes korsisë së ngadalësimit					
8	Parakalimi i mjeteve të tjera, kalimi i pengesave (për shembull mjete të parkuara); të qënit objekt i parakalimit nga ana e mjeteve të tjera					
9	Prova ne rrethrrotullime, kalime në nivel, ndalesa të autobusëve, përmeskalime të këmbësorëve					
10	Drejtimi i mjetit në ngjitje/zbritje të gjata, ndalimi dhe nisja nga vendi në rrugët në ngjitje					
11	Përdorimi i duhur i marsheve dhe freksionit sipas kushteve te rrugës					
12	Zotërimi i timonit, mbajtja e krahut të duhur në qarkullim					
13	Respektimi i sinjaleve vertikale dhe horizontale					
14	Masat për daljen e sigurt nga mjeti					
REZULTATI I PROVËS (Fiton / Nuk fiton)						

Kandidati (_____) fiton "Provën e aftësive drejtuese dhe të sjelljes" për leje drejtimi të kategorisë "_____"me vendimin e komisionit Nr/prot._____ datë _____

KOMISIONI

ANËTARI

(_____)

(_____)

Emër, mbiemër, firmë

KRYETARI

Emër, mbiemër, firmë

Modeli DL 2 / P

REGJISTRI I KANDIDATËVE PËR DREJTUES MJETI (PRAKTIKË)

Nr.	Datë	Emër, atësi, mbiemër	Datëlindja	Vendlindja Vendbanimi	Seksi	Teoria			Praktika				
					M/F	Nr. prot	Data	Kateg.	Emri Autoshkolla	Mjeti targa	Instruktori	Data e fillimit	Data e mbarimi
1													
2													
3													
4													
5													
6													
7													
8													
9													
10													
11													
12													
13													
14													
15													
16													
17													
18													
19													
20													
21													
22													
23													
24													
25													
26													
27													

28													
29													
30													

Modeli DL 3 / P

REGJISTËR PROTOKOLLI PËR MARRJEN NË PROVA PRAKTIKE NR._____ DATË___/___/_____

Nr.	Emër, mbiemër	Atësia	Amësia	Datëlindja	Vendlindja	Vendbanimi *(Adresa)*	Teoria			Autoshkolla		Nr. i provimit	Rezultati i praktikës	Rezultati përfundimtar (me shkrim + kategoria)
							N. prot.	*Data*	*Kateg.*	Nr.amzës	*Emri*			
1														
2														
3														
4														
5														
6														
7														
8														
9														
10														
11														
12														
13														
14														
15														
16														
17														
18														
19														
20														
21														
22														
23														
24														

25													
26													
27													
28													
29													
30													